



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

01 ref. 13
07.05.2021

Mbështetur në nenet 92.4 dhe 93(4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, si dhe nenin 8.1.4 dhe pikën 12.3 të shtojcës 1 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Anulohen** neni 1, paragrafët 2 dhe 3 të nenit 2, nenet 3 deri në 53, nenet 58 dhe 59, si dhe paragrafi 2 i nenit 60 të Udhëzimit administrativ (MTI) nr. 09/2020 për kontrollin dhe cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës, i botuar në Gazetën Zyrtare më 16 nëntor 2020.
2. **Detyrohen** organet përgjegjëse të zbatojnë Udhëzimin administrativ (MTI) nr. 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës, i botuar në Gazetën Zyrtare më 15 shkurt 2017.
3. Ky vendim hyn në fuqi pasi të botohet në Gazetën Zyrtare.

Arsyetim

Dispozitat kyçe të Udhëzimit administrativ (MTI) nr. 09/2020 për kontrollin dhe cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës (tutje “Udhëzimi 09/2020”) janë qartazi në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, andaj duhet të revokohen.

Neni 7.1 i Kushtetutës njeh sundimin e ligjit si vlerë të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Neni 92.3 detyron Qeverinë, duke përfshirë ministrat, të zbatojnë ligjet dhe të veprojnë “brenda përgjegjësisë të përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.” Përfundimisht, sipas nenit 93(4) të Kushtetutës, Qeveria “merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve”.

Lidhur me parimin e sundimit të ligjit, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) rikujton:

Parakusht themelor i sundimit të ligjit është që kompetencat e autoriteteve publike të përcaktohen me ligj. Për aq sa ligjshmëria trajton veprimet e zyrtarëve publikë, kërkohet gjithashtu që ata të kenë autorizim për të vepruar dhe që ata mandej të veprojnë brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë, dhe që rrjedhimisht të respektojnë të drejtën procedurale dhe materiale. (Lista e Kontrollit për Sundimin e Ligjit, *Rule of Law Checklist*, 18.3.2016, CDL-AD(2016)007rev, para. 45.)

Lidhur me nenin 93(4) të Kushtetutës, Komentari thekson:

Autorizimi për të nxjerrë akte nënligjore, megjithatë, kufizohet me këto kushte: a) që akti nënligjor të rregullojë një fushë juridike që rregullohet përmes ligjit të nxjerrë nga ana e Kuvendit; b) që akti nënligjor të mos shkel një ndalesë të vënë nga ana e ligjit përkatës; c) që akti nënligjor të ndjek qëllimin dhe objektivat e ligjit, dhe që akti nënligjor përkatës të jetë në përputhje të plotë me kushtetutën; dhe, d) që akti nënligjor të ketë karakter konkretizimi të normave abstrakte të ligjit përkatës. Nëse akti nënligjor përkatës plotëson këto katër kushte, atëherë fuqia e tij juridike buron drejtpërdrejtë nga ky paragraf i kushtetutës. (Enver Hasani, *Komentari: Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, bot. 1, neni 93(4), kmt. 2, fq. 440).

Një udhëzim administrativ pra, si akt nënligjor i Qeverisë ose Ministrisë, duhet nxjerrë brenda autorizimeve që jep ligji.

Udhëzimi 09/2020 është miratuar nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, duke u thirrur në nenin 9 të Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, siç është ndryshuar me nenin 11 të Ligjit nr. 03/L-138:

Neni 9

STANDARDET E NAFTËS DHE DERIVATEVE TË NAFTËS

9.1. Ministria do të shqyrtojë dhe miratojë, me akt nënligjor, standardet për cilësi të naftës dhe derivate të naftës, duke marrë për bazë standardet e harmonizuara të BE-së dhe standardet ndërkombëtare.

9.2. Gjatë përcaktimit të standardeve, sipas paragrafit 1 të këtij neni, Ministria duhet të ketë çdo herë parasysh që aplikimi i tyre të mos shkaktojë ç'rregullime në furnizimin e tregut me naftë dhe derivate të naftës, apo favorizim të një prodhuesi apo vendi.

9.3. Ministria do të shqyrtojë në vazhdimësi standardet duke marrë për bazë përputhshmërinë e tyre me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Kjo dispozitë autorizon Ministrinë të nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar standardet për cilësinë e naftës dhe derivateve të naftës, duke marrë për bazë standardet e harmonizuara të Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare. Mirëpo, nuk autorizon Ministrinë me nxjerrë akt nënligjor posaçërisht për kontrollin e karburanteve të lëngëta të naftës para hyrjes në treg.

Cilësia e produkteve kontrollohet sipas Ligjit nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit. Nenet 53 dhe 54.1 të këtij ligji përcaktojnë:

Neni 53

Zbatimi i dispozitave të kontrolleve kufitare

Nenet 54, 55 dhe 56 të këtij ligji do të zbatohen për të gjitha produktet që mbulojnë nga legjislacioni teknik i Kosovës, deri në masën që ligjet specifike nuk përbajnë dispozita më specifike në lidhje me organizimin e kontrolleve kufitare.

Neni 54

Kontrolli i produkteve që hyjnë në treg

1. Dogana e Kosovës ka kompetencat dhe burimet e nevojshme për kryerjen në mënyrë të duhur të detyrave të tyre. Ata do të kryejnë kontrole të përshtatshme të karakteristikave e produkteve në një shkallë përkatëse, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 44 paragrafi 1 të këtij ligji, para se ato produkte të lëshohen në qarkullim të lirë [...]

Neni 10.1 i Ligjit për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, ndryshuar dhe rinumëruar me nenin 12 të Ligjit 03/L-138, thotë:

Ministria mbikëqyrë dhe inspekton cilësinë e naftës dhe derivate të naftës *në treg* [theksim i shtuar].

Pra, para se nafta dhe derivatet të hyjnë në treg, kontrollin e cilësisë e bën Dogana, sipas Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit. Pasi nafta dhe derivatet të hyjnë në treg, kontrollin e cilësisë e kryen Ministria (tani e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë), sipas Ligjit për tregtinë me naftës dhe derivate të naftës në Kosovë.

Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 51 [Verifikimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës në territorin Doganor] të Udhëzimit 09/2020, përcaktojnë se:

1. Para se të miratohet hyrja e karburanteve të lëngëta të naftës në qarkullim në tregun e Kosovës, Trupat për Vlerësim të Konformitetit (TVK) i emëruar nga MTI, është kompetent për të kryer verifikimin adekuat të karakteristikave të karburanteve të lëngëta të naftës që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Kosovës, dhe të bëjë verifikimin e dokumenteve të konformitetit të lëshuar jashtë territorit të Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin përkatës.
2. Gjatë procesit të miratimit të hyrjes së karburanteve të naftës, Trupat për Vlerësim të Konformitetit verifikon dokumentet e konformitetit, përfshirë, deklaratën e konformitetit apo deklaratën e cilësisë, e cila duhet të ketë të bashkangjitur raportin e testimit, në pajtim me parametrat e parapara me udhëzimin bazë. Dogana e Kosovës lejon hyrjen e karburanteve të naftës në territorin e Kosovës, vetëm nëse çertifikata / raporti i lëshuar nga një TVK e emëruar nga MTI, e cila është konform me udhëzimin bazë.[sic]

Sipas nenit 51 të Udhëzimit 09/2020, trupat e emëruar nga Ministria verifikojnë karburantet që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Kosovës – pra, i kontrollojnë para hyrjes në treg; Dogana lejon hyrjen e këtyre karburanteve vetëm nëse operatori ekonomik është i pajisur me raportin e testit nga trupa. Kështu, Udhëzimi 09/2020, i nxjerrë nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, i cakton detyrime Doganës së Kosovës.

Sipas nenit 9 të Kodit doganor dhe të akcizave, nr. 03/L-109, Dogana është i vetmi institucion në Kosovë që ka kompetencë për të kryer detyra doganore dhe detyra të tjera që i caktohen nga Qeveria. Pra, Doganës mund t'i caktojë detyra vetëm Qeveria, jo ministrat individualisht.

Neni 51 i Udhëzimit 09/2020 bie në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, meqë ky ligj e autorizon Doganën e Kosovës për kontrollin e produkteve para hyrjes në treg. Tutje, neni 51 i Udhëzimit 09/2020 bie në kundërshtim me nenin 9 të Kodit doganor dhe të akcizave, sepse përcakton detyra për Doganën.

Kompetencat për njohjen dhe pranimin e dokumenteve të konformitetit të naftës dhe derivateve të naftës është propozuar t'u hiqen trupave për vlerësimin e konformitetit dhe t'i barten Doganës qysh më 2016. Arsyeja thelbësore ka qenë:

që të evitohet mospajtueshmëria e Udhëzimit Administrativ [MTI] nr. 07/2012, për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet përkatëse; të përmbushen obligimet e Republikës së Kosovës për lëvizjen e lirë të mallrave, obligime që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociim; të krijohen mekanizma efikas për kontrollimin e cilësisë së naftës dhe produkteve të naftës, si dhe të evitohet konflikti i interesit i MTI-së në sektorin e naftës, për shkak se MTI-ia është duke ushtruar disa veprimtari që janë në konflikt të interesit me njëra-tjetrën. (Memorandum shpjegues, fq. 2, bashkëngjitur shkresës nr.prot. [MTI] 01-3099, 13.6.2016.)

Udhëzimi administrativ (MTI) nr. 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës ka bartur kompetencën mbi dokumentet e konformitetit nga trupat e jashtëm te Dogana e Kosovës, në përputhje me Kodin doganor dhe të akcizave. Në përgatitjen e kapaciteteve të Doganës ka ndihmuar Bashkimi Evropian përmes instrumentit të Asistencës Teknike dhe Këmbimit të Informatave, i njohur si TAIEX. Dogana gjithashtu ka realizuar investim kapital mbi 1 milion euro për të ndërtuar laboratorin e naftës. Udhëzimi 09/2020 ka shfuqizuar Udhëzimin 01/2017, duke e detyruar Doganën të mbyllë laboratorin.

Si dispozitë e paligjshme, neni 51 i Udhëzimit 09/2020 ndërlidhet posaçërisht me nenin 1, paragrafët 2–3 të nenit 2, nenet 3–50, nenet 52–53, nenet 58–59, si dhe paragrafin 2 të nenit 60 të të njëjtit udhëzim. Duke vërejtur se këto dispozita janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, dhe me qëllim për të rikthyer ligjshmërinë, Ministria vendosi si në dispozitiv.

Rozeta HAJDARI
Rozeta Hajdari
Ministre



U dërgohet:

- Gazetës Zyrtare
- Zyrës së Kryeministrit
- Doganës së Kosovës
- Kabinetit të Ministres
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Departamentit Ligjor
- Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftës
- Inspektoratit të Tregut
- Arkivit